



Recommendation concerning prison overcrowding and prison population inflation

Unofficial translation into Albanian

Recommandation concernant le surpeuplement des prisons et l'inflation carcérale

Traduction non officielle en albanais

Rekomandimi Nr. R (99) 22 në lidhje me mbipopullimin në burgje dhe inflacionin e popullsisë në burgje

© Council of Europe, original English and French versions

Text originated by, and used with the permission of, the Council of Europe. This unofficial translation is published by arrangement with the Council of Europe, but under the sole responsibility of the translator.

* * * * *

© Conseil de l'Europe, versions originales en anglais et français

Le texte original provient du Conseil de l'Europe et est utilisé avec l'accord de celui-ci. Cette traduction est réalisée avec l'autorisation du Conseil de l'Europe mais sous l'unique responsabilité du traducteur.

KËSHILLI I EVROPËS KOMITETI I MINISTRAVE

Rekomandimi Nr. R (99) 22 në lidhje me mbipopullimin në burgje dhe inflacionin e popullsisë në burgje

(Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 30 shtator 1999 në mbledhjen e 681-të të Zëvendësministrave)

Komiteti i Ministrave, sipas kushteve të Nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Evropës,

Duke marrë parasysh se mbipopullimi dhe rritja e popullsisë së burgjeve paraqesin një sfidë madhore për administratat e burgjeve dhe sistemit të drejtësisë penale në tërësi, si në termat e të drejtave të njeriut, ashtu edhe të menaxhimit efektiv të institucioneve penale;

Duke marrë parasysh se menaxhimi efektiv i popullsisë së burgjeve varet nga çështje të tilla si situata e përgjithshme e krimit, përparësitë në kontrollin e krimit, seria e ndëshkimeve të mundshme sipas librave të së drejtës, ashpërsia e dënimit të dhënë, shpeshtësia e përdorimit të sanksioneve dhe masave në komunitet, përdorimi i arrestit me burg para gjykimit, efikasiteti dhe efektshmëria e agjencive të drejtësisë penale dhe jo më pak e rëndësishme qëndrimi publik ndaj krimit dhe ndëshkimit;

Duke pohuar se masat që kanë si synim luftën kundër mbipopullimit të burgjeve dhe uljen e masës së popullsisë së burgjeve duhet të jenë të ngulitura në një politikë koherente dhe racionale të krimit që shkon drejt parandalimit të krimit dhe sjelljes kriminale, zbatimit efektiv të ligjit, sigurisë dhe mbrojtjes publike, individualizimit të sanksioneve dhe masave dhe ri-integritit social të autorëve të veprave penale;

Duke marrë parasysh se masa të tilla duhet t'u përshtaten parimeve bazë të shteteve demokratike të qeverisura nga shteti i së drejtës dhe që janë subjekte të synimit madhor të garantimit të të drejtave të njeriut, në përputhje me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe praktikën gjyqësore të organeve të cilave u është besuar zbatimi i tyre;

Duke pranuar më tej se masa të tilla kërkojnë mbështetje nga drejtuesit politikë dhe administrativë, gjyqtarët, prokurorët dhe publiku në përgjithësi, si edhe sigurimin e informacionit të ekuilibruar në lidhje me funksionet e ndëshkimit, për efikasitetin relativ të sanksioneve dhe masave të arrestit me burg dhe për realitetin e burgjeve;

Duke mbajtur në mendje Konventën Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues;

Duke njohur rëndësinë e Rekomandimit Nr. R (80) 11 në lidhje me arrestin me burg në pritje të gjykimit, Rekomandimit Nr. R (87) 3 për Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rekomandimit Nr. R (87) 18 në lidhje me thjeshtimin e drejtësisë penale, Rekomandimit Nr. R (92) 16 për Rregullat Evropiane për sanksionet dhe masat në komunitet dhe Rekomandimit Nr. R (92) 17 në lidhje me konsistencën në dhënien e dënimit,

Rekomandon që qeveritë e shteteve anëtare:

- gjatë shqyrtimit të legjislacionit dhe praktikës së tyre në lidhje me mbipopullimin e burgjeve dhe inflacionin e popullsisë së burgjeve, të marrin të gjitha masat e përshtatshme, për të zbatuar parimet e vendosura në shtojcën e këtij rekomandimi;

- të nxisin përhapjen më të gjerë të mundshme të rekomandimit dhe raportit për mbipopullimin e burgjeve dhe inflacionin e popullsisë së burgjeve të hartuar nga Komiteti Evropian për Problemet me Krimin.

Shtojca ndaj Rekomandimit (99) 22

I. Parimet bazë

1. Heqja e lirisë duhet të konsiderohet një sanksion ose masë si opsion i fundit dhe, si e tillë, duhet të parashikohet vetëm për rastet kur serioziteti i shkeljes së ligjit do ta bënte qartësisht të papërshtatshëm çdo sanksion ose masë tjetër.

2. Zgjerimi i terrenit të burgjeve duhet të jetë më tepër një masë e jashtëzakonshme, sepse gjasat që të ofrojë një zgjidhje afatgjatë për problemin e mbipopullimit përgjithësisht janë të pakta. Shtetet në të cilat kapaciteti i burgjeve mund të jetë i mjaftueshëm në terma të përgjithshëm, por jo i mirë-përshtatur ndaj nevojave lokale, duhet të përpiqen të arrijnë një shpërndarje më racionale të kapacitetit të burgjeve.

3. Duhet marrë masat e nevojshme për një organizim të përshtatshëm të sanksioneve dhe masave në komunitet, mundësisht të kategorizuara në terma të ashpërsisë relative; prokurorët dhe gjyqtarët duhet të nxiten t'i përdorin ato sa më gjerësisht që të jetë e mundur.

4. Shtetet anëtare duhet të marrin në konsideratë mundësinë e dekriminalizimit të disa llojeve të shkeljes së ligjit ose t'i klasifikojnë ato sërish në mënyrë që të mos tërheqin ndëshkime ku përfshihet heqja e lirisë.

5. Në mënyrë që të ndërtohet një strategji koherente kundër mbipopullimit të burgjeve dhe inflacionit të popullsisë në burgje, duhet të bëhet një analizë e detajuar e faktorëve kryesorë që kontribuojnë në to, duke adresuar veçanërisht çështje të tilla si llojet e shkeljeve të ligjit që mbartin dënime të gjata me burg, përparësitë e kontrollit të krimit, qëndrimet dhe shqetësimet publike dhe praktikatat ekzistuese të dënimit.

II. Përballimi i një mungese vendesh në burg

6. Në mënyrë që të shmangen nivelet e tepërta të mbipopullimit, duhet vendosur një kapacitet maksimal për institucionet penale.

7. Kur ndodhin raste të mbipopullimit, theks i veçantë duhet vënë mbi normat e dinjitetit njerëzor, përkushtimin e administratës së burgjeve për të zbatuar trajtim njerëzor dhe pozitiv, njohjen e plotë të roleve të stafit dhe përjasjeve moderne efektive të menaxhimit. Në përputhje me Rregullat Evropiane të Burgjeve, vëmendje e veçantë i duhet kushtuar hapësirës në dispozicion të të burgosurve, higjienës dhe kushteve sanitare, sigurimit të ushqimit të mjaftueshëm, të përgatitjes së paraqitur siç duhet, kujdesit shëndetësor të të burgosurve dhe mundësisë për ushtrim fizik në ambient të jashtëm.

8. Për të neutralizuar disa prej pasojave negative të mbipopullimit të burgjeve, kontaktet e të burgosurve me familjet e tyre duhen lehtësuar sa të jetë e mundur, si dhe duhet bërë përdorim maksimal i mbështetjes nga komuniteti.

9. Duhet përdorur sa më shumë të jetë e mundur modalitete specifike për zbatimin e dënimeve me arrest me burg, të tilla si gjysmëliri, regjime të hapura, leje nga burgu, ose vendosja në institucione jashtë burgut, me synim që të kontribuojnë në trajtimin dhe rivendosjen e të burgosurve, për të mbajtur lidhjet e tyre familjare dhe lidhje të tjera në komunitet, si dhe për të zvogëluar tensionin në institucionet penale.

III. Masa që lidhen me fazën para gjykimit

Shmangia e procedurave penale – Ulja e përdorimit të burgimit para gjykimit

10. Duhet marrë masa të përshtatshme me synim zbatimin e plotë të parimeve të parashtruara në Rekomandimin Nr. R (87) 18 në lidhje me thjeshtimin e drejtësisë penale; kjo do të përfshijë veçanërisht që shtetet anëtare, teksa marrin në konsideratë parimet e veta kushtetuese ose traditën ligjore, të zbatojnë parimin e ndjekjes penale diskrecionale (ose masa që kanë të njëjtin qëllim) dhe të përdorin procedura të thjeshtuara dhe marrëveshje jashtë gjyqësore si alternativa ndaj ndjekjes penale në raste të përshtatshme, në mënyrë që të shmangin procedurat e plota penale.

11. Zbatimi i arrestit me burg para gjykimit dhe gjatësia e tij duhet të ulen në minimumin e përputhshëm me interesat e drejtësisë. Për këtë qëllim, shtetet anëtare do të sigurohen që ligji dhe praktika e tyre të jenë në përputhje me dispozitat përkatëse të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe praktikën ligjore të organeve të saj të kontrollit, dhe të udhëhiqet nga parimet e parashtruara në Rekomandimin Nr. R (80) 11 në lidhje me arrestin me burg në pritje të gjykimit, veçanërisht për sa i përket bazave mbi të cilat mund të urdhërohet kjo masë arresti.

12. Duhet bërë përdorimi më i gjerë i mundshëm i alternativave ndaj arrestit me burg para gjykimit, si kërkesa që personi i dyshuar për shkelje ligji të banojë në një adresë të specifikuar, kufizim nëhyrjen ose daljen pa autorizim nga një vend i caktuar, dhënien e garancisë ose mbikëqyrje dhe asistencë nga një agjenci e përcaktuar nga autoriteti gjyqësor. Në lidhje me këtë, i duhet kushtuar vëmendje mundësive për mbikëqyrjen e detyrimit për të qëndruar në një vend të caktuar përmes mjeteve elektronike të mbikëqyrjes.

13. Për të ndihmuar në përdorimin efikas dhe njerëzor të arrestit me burg para gjykimit, duhen vënë në dispozicion burimet e përshtatshme financiare dhe njerëzore dhe duhen zhvilluar mjetet e përshtatshme procedurale dhe teknikat e menaxhimit, sipas nevojës.

IV. Masa në lidhje me fazën e gjykimit

Sistemi i sanksioneve/masave – gjatësia e dënimit

14. Duhet bërë përpjekje për të ulur përdorimin e dënimeve që përfshijnë burgim të gjatë, gjë që vendosin një barrë të rëndë mbi sistemin e burgjeve, si dhe për të zëvendësuar dënimet e shkurtra me burg me sanksione dhe masa në komunitet.

15. Në dhënien e sanksioneve dhe masave në komunitet që do të mund të përdoren në vend të heqjes së lirisë, duhen marrë parasysh pikat e mëposhtme:

- pezullimi i zbatimit të një dënimi me burg me kushtet e caktuara;

- shërbimi i provës si një sanksion i pavarur i vendosur pa shpalljen e një dënimi me burgim;

- mbikëqyrja me intensitet të lartë;
- shërbimi në komunitet (d.m.th. punë pa pagesë në dobi të komunitetit);
- urdhrat e trajtimit / trajtim kontraktues për kategori të përcaktuara autorësh të veprave penale;
- ndërmjetësimi viktimë-autor i veprës penale/ dëmshpërblimi i viktimës;
- kufizimet e lirisë së lëvizjes, për shembull me anë të urdhrave për mbylljen brenda pas orëve të caktuara ose monitorimit elektronik.

16. Sanksionet dhe masat në komunitet duhet të vendosen vetëm në përputhje me garancitë dhe kushtet e parashtruara në Rregullat Evropiane për Sanksionet dhe Masat në Komunitet.

17. Kombinime të sanksioneve dhe masave me dhe pa burg duhen futur në legjislacion dhe praktikë, të tilla si dënime të pandërprera me burgim, të vijuara nga shërbimi në komunitet, mbikëqyrja (intensive) në komunitet, arrest shtëpie me mbikëqyrje elektronike, ose, në raste të përshtatshme, me detyrimin për t'iu nënshtruar trajtimit.

Dhënia e dënimit dhe roli i prokurorëve dhe gjyqtarëve

18. Gjatë zbatimit të ligjit, prokurorët dhe gjyqtarët duhet të përpiqen të kenë parasysh burimet që kanë në dispozicion, veçanërisht për sa i përket kapacitetit të burgjeve. Në lidhje me këtë, vëmendje e vazhdueshme duhet t'i kushtohet vlerësimit të ndikimit që strukturat ekzistuese të dhënies së dënimit dhe politikave të planifikuara të dhënies së dënimit kanë mbi evolucionin e popullsisë së burgjeve.

19. Prokurorët dhe gjyqtarët duhet të jenë të përfshirë në procesin e përgatitjes së politikave penale në lidhje me mbipopullimin e burgjeve dhe inflacionin e popullsisë së burgjeve, me synim angazhimin e mbështetjes së tyre dhe shmangien e praktikave joproductive të dhënies së dënimit.

20. Arsyeimi për dhënien e dënimit duhet të caktohet nga ligjbërësi ose autoritete të tjera kompetente, me synim që, ndër të tjera, të ulin përdorimin e burgimit, të zgjerojnë përdorimin e sanksioneve dhe masave në komunitet, dhe të përdorin masa devijuese të tilla si ndërmjetësimi ose dëmshpërblimi i viktimës.

21. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar rolit që luajnë faktorët rëndues dhe lehtësues, si edhe dënimet e mëparshme, në përcaktimin e masës së përshtatshme të dënimit.

V. Masa në lidhje me fazën pas gjykimit

Vënia në zbatim i sanksioneve dhe masave në komunitet – Zbatimi i dënimeve me burgim

22. Në mënyrë që sanksionet dhe masat në komunitet të bëhen alternativa të besueshme ndaj burgimeve afatshkurtra, duhet siguruar zbatimi efektiv i tyre, veçanërisht përmes:

- sigurimit të infrastrukturës për ekzekutimin dhe monitorimin e sanksioneve të tilla në komunitet, e rëndësishme edhe për t'u dhënë prokurorëve dhe gjyqtarëve besim në efikasitetin e tyre; dhe

- zhvillimit dhe përdorimit të teknikave të besueshme të parashikimit dhe vlerësimit të riskut , si edhe strategjive të mbikëqyrjes, me synim identifikimin e riskut që autori i veprës penale t'i rikthehet veprës dhe sigurimin e mbrojtjes dhe sigurisë publike.

23. Duhet të promovohet zhvillimi i masave që ulin gjatësinë reale të dënimit për t'u vuajtur, duke i dhënë preferencë masave të individualizuara si lirim i parakohshëm me kusht, përkundëjt masave kolektive për menaxhimin e mbipopullimit të burgjeve (amnistitë, faljet kolektive).

24. Lirimi me kusht duhet të cilësohet si një prej masave më efikase dhe konstruktive që, jo vetëm ulë gjatësinë e burgimit, por edhe kontribuon në mënyrë domethënëse në një kthimi të planifikuar të autorit të veprës në komunitet.

25. Për të promovuar dhe zgjeruar përdorimin e lirit me kusht, duhen krijuar kushtet më të mira të mundshme për mbështetjen, ndihmën dhe mbikëqyrjen e autorit të veprës penale , me synimin për t'i nxitur autoritetet kompetente gjyqësore ose administrative që ta konsiderojnë këtë masë si një opsion të vlefshëm e të përgjegjshëm.

26. Programe efektive për trajtimin gjatë arrestit me burg dhe për mbikëqyrjen dhe trajtimin pas lirit duhen përgatitur dhe zbatuar në mënyrë që të lehtësohet rivendosja e autorëve të veprave penale , të ulët recidivizmi, të garantohet siguria dhe mbrojtja publike dhe t'u krijohet besimi gjyqtarëve dhe prokurorëve se masat që synojnë uljen e gjatësisë reale të dënimit që duhet kryer dhe sanksionet e masat në komunitet janë opsione konstruktive e të përgjegjshme.